



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/ Ministarstvo Obrazovanja i
Nauke/ Ministry of Education, and Science*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 01B/312
Datë: 12.10.2021

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të nenit 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare nr. 7 / 01 mars 2019), , si dhe nenit 30 shtojca nr. 7 e Rregullores (QRK) nr. 2/2021 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

Për organizimin e procesit mësimor më 18 tetor 2021

1. Më 18 tetor 2021, është ditë mësimi.
2. Njoftojmë DKA-të që shkollat të cilat më datë 17 tetor kanë qenë qendra të votimit, mësimin më datën 18 tetor ta zhvillojnë sipas skenarit C, ndërsa shkollat të cilat nuk kanë qenë qendra të votimit procesin mësimor e vijojnë sipas planifikimeve paraprake.
3. Obligohen DKA-të që pas përfundimit të votimeve, shkollat të dezinfektohen dhe ajrosen mirë në mënyrë që të jenë të gatshme për mbajtjen e procesit mësimor më 19 tetor.
4. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Duke u bazuar në dispozitat e shënuara më lartë si dhe nevojën për të garantuar rikthim të sigurt në shkolla, zbatim të masave Anti-COVID, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Z.v. Sekretares së Përgjithshëm te MASHTI;
2. DKA-ve;
3. Kabinetit të Ministres/MASHTI;
4. Departamentit të arsimit parauniversitar/MASHTI;
5. Arkivit/MASHTI.

Arbërie Nagavci

Ministre MASHTI

